REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr.1640 prot. **Prrenjas, më 25.07.2025**

SHPALLJE PËR 1 (NJË) VEND TË LIRË PUNE

Bashkia Prrenjas për nevoja të plotësimit të vendeve të punës, shpall për konkurim **vend të lirë pune**, në pozicionin si vijon:

1(një) vend pune Drejtor në Agjencinë e Funksioneve,Bashkia Prrenjas

Detyrat kryesore:

Drejtori është përgjegjës për menaxhimin strategjik dhe operacional të agjencisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat e zhvillimit të bashkisë.

Kandidatët që kërkojnë të aplikojnë për konkurim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Kritere të përgjithshme:

- Të kenë shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushin kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kritereve të miratuara;
- Të jenë të aftë për punë;
- Të mos jenë të dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kritere specifike për pozicionin e punës:

- Diplomë universitare master shkencor ose e barasvlefshme me të në Drejtësi, Ekonomi Financë, Biznes, Menaxhim, Administratë Publike.
- Të paktën 5 vite përvojë pune në administratën publike ose në menaxhim institucional, nga të cilat të paktën 3 vite në pozicion drejtues.
- Njohuri të thella të legjislacionit për vetëqeverisjen vendore.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, organizimi dhe drejtimi të stafit.
- Njohuri të mira kompjuterike dhe zotërim i gjuhës angleze përbën avantazh.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Curriculum Vitae;
- Diplomë master shkencor ose e barasvlefshme me të.
- Listë notash;
- Dëshmi të ndryshme kualifikimi dhe specializimi;
- Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor;
- Dëshmi penaliteti, ku të vërtetohet që nuk jeni i dënuar
- Çertifikatë e gjendjes personale dhe familjare;
- Fotokopje e ID-së.

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët që do të aplikojnë për konkurim duhet të paraqesin dokumentet e mësipërme brenda dates 04.08.2025.

KRYETARI I BASHKISË
Nuri Belba

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PRRENJAS